

MENDIM PARALEL

Unë, Lulzim Hamitaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër – duke mbështetur vendimmarrjen përfundimtare për shkarkimin e saj nga detyra, por duke mos qenë dakord me një qëndrim të mbajtur nga të dy anëtarët e tjerë të trupit – në vijim po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe ndaj arsytimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me: (i) pamjaftueshmërinë e elementeve/gjetjeve që lidhen me kriterin e aftësive profesionale, për mbërritjen në konkluzionin e cenimit të besimit të publikut, si shkak për aplikimin e nenit 61, pika 5; (ii) mjaftueshmërinë e disa rrethanave/gjetjeve në kriterin e pasurisë, që edhe nëse do të kryhej një vlerësim alternativ, duke u ndalur vetëm në ligjshmërinë e burimeve financiare, do të rezultonin të mjaftueshme për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në këtë rast.

1. Lidhur me analizimin e rrethanave në raport me kriterin e aftësive profesionale, e konkretisht me konkluzionet, në pikën 57: *“Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi të theksuara në aspektin e njohurive ligjore duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe, në aspektin e arsytimit ligjor, duke u bazuar në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, kritere që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016”, si dhe në pikën 74: “Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek organet e drejtësisë, pasi në ndjekjen e procedimit penal nr. ***, viti 2022, ka vepruar në kundërshtim me parimin e paanësisë të parashikuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës”* – vlerësoj se konstatimet e përshkruara në këtë vendim nuk janë të mjaftueshme në aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 pasi, në këndvështrimin tim, nuk mjafton konstatimi i problematikave në një çështje profesionale të izoluar për të mbërritur në konkluzionin e cenimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, për sa kohë do të duhej një numër më i lartë dhe më i qartë shkeljesh etiko-profesionale – me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme me peshë specifike domethënëse, ku mund të jenë konsumuar shkelje tejet të rënda dhe qartazi të papërputhshme me funksionin e magjistratit. Në këto rrethana vlerësoj se, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, përmbajtja e fakteve të mësipërme nuk mjafton për të përbërë një shkak shkarkimi në vetvete. Gjithashtu, vlerësoj se përmbajtja konkluzive e pikës 57, nëse do të ishte rrjedhojë e problematikave të gjetura në një seri çështjesh profesionale (dhe nuk është ky rasti), do të mund të çonte në aplikimin e pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për papërshtatshmëri profesionale, dhe jo në pikën 5 të kësaj dispozite, për cenimin e besimit të publikut.

Si përfundim, gjetjet e lartpërmendura lidhur me kriterin profesional, sipas meje, nuk mjaftojnë në vetvete për të penalizuar subjektin e rivlerësimit. Për më tepër, çmoj se lidhur me këtë kriter Komisioni do të duhej të shprehej nëse subjekti mbërrin ose jo në një nivel kualifikues (në pikën 75 të vendimit ky vlerësim mungon), pasi vlerësimi në raport me cenimin e mundshëm të besimit të publikut duhet të kryhet veçmas, nëpërmjet një këndvështrimi gjithëpërfshirës dhe pa iu zëvendësuar apo mbivendosur konkludimit mbi

ndonjëherë prej tri kritereve, duke pamundësuar kësisoj kristalizimin e një vlerësimi përfundimtar nga ana e Komisionit, në këtë rast lidhur me kriterin e aftësive profesionale.

2. Ndërkohë, ndonjëse e çmoj të bazuar shkarkimin e subjektit të rivlerësimit në raport me kriterin e pasurisë, vlerësoj të evidentoj faktin se, edhe nëse Komisioni nuk do të konkludonte për aplikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës - përfundim ky i mbërritur nga deduksioni i një sërë faktorëve rrethanorë dhe faktikë, të hasur në mënyrë të përsëritur në dinamikën e pasurisë familjare të subjektit, - gjithësesi do të mjaftonte mungesa e burimeve të ligjshme financiare të konstatuara për aplikimin e masës për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

Kësisoj, vlen të theksohet se, përpos aplikueshmërisë së nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në këtë rast do të mjaftonte edhe vetëm një vlerësim alternativ, duke u përqendruar në mungesën e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të krijuara - nga familja e subjektit dhe (së paku pjesërisht) të përfituara nga kjo e fundit (përfshirë këtu edhe depozitat bankare dyemërore), - si dhe lidhur me pamjaftueshmërinë e deklarimeve të vetë subjektit, sikurse është konstatuar e përshkruar në vendimin *de quo*, për të mbërritur në masën e shkarkimit të subjektit nga detyra dhe aplikimin e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

Lulzim HAMITAJ
Anëtar i trupit gjykues